



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.171/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja e Vetëvendosje (LVV), dega në Lipjan, për shkak të thyerjes së kodit të mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, ndërsa subjektit politik Lëvizja e Vetëvendosje (LVV), dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 550.00 euro (Pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 10.10.2017, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendon se zyrtar të shtabit Zgjedhor të LDK-së në Lipjan, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e një tavoline me material zgjedhor dhe banerëve me foto e logo të subjektit LVV, për qëllime të fushatës nga subjekti politik LVV, në rrugën “Lidhja e Prizrenit”, në Lipjan. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LVV, ka vepruar në kundërshtim me nenit 33 pika b) të LZP-së dhe Rregullave Zgjedhore 11/2013 dhe 13/2014. Gjithashtu, subjekti politik LDK, ka propozuar që subjektit politik LVV-së ti shqiptohet masa e sanksionimit konform nenit 3.2 të Rregullës së PZAP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik LVV, e konsideron si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK, pasi që Qendra e LVV-së në Lipjan më datë 03.10.2017, ka bërë kërkesë në Drejtoratin e Shërbimëve Publike të Komunës së Lipjanit, për vendosjen e materialit zgjedhor në rrugën “Lidhja e Prizrenit” dhe për këtë ka marr Pëlqim nga Komuna për të vendosur ato materiale zgjedhore në atë rrugë prej dt. 04.10.2017 deri më 19.10.2017.

Përgjigjes në ankesë si provë i ka bashkangjitur kërkesen e dt.03.10.2017 dhe Pëlqimin e Komunës të dt.04.10.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik LVV ka vendosur një tavolinë me material zgjedhor dhe baner me foto e logo të subjektit LVV, për qëllime të fushatës zgjedhore në rrugët e qytetit, edhe pse kanë marr leje nga Komuna e Lipjanit, për vendosjen e materialit të tillë zgjedhor mirëpo, vendosja e materialëve të subjektëve politike në rrugë, është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LVV ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë mohuar shkeljen e supozuar. Pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë.

Paneli për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qartë dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par.3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara ka rezultuar se Komuna e Lipjanit e ka miratuar kërkesën e subjektit politik LVV dhe ka lejuar vendosjen e tendës në hapësirë publike për zhvillimin e aktivitetit për promovimin e programit qeverisës dhe për shpërndarjen e broshurave lidhur me fushatën zgjedhore nga data 04.10.2017 deri më 19.10.2017 në Lipjan, mirëpo këto veprime sipas vlerësimit të Panelit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore neni 33 pika b) e LZP-së si dhe neni 5 paragrafi 1 pika b) e Rregullës 13/2013, andaj ndonëse subjekti politik ka marrur pëlqimi paraprak për vendosjen e materialit zgjedhor, i njëjti është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet dhe veprimet në kundërshtim me ligjin nuk mund ti justifikohen, pasi LVV janë subjekt i cili nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe është dashur të dijë cilat veprime janë të ndaluara.

Paneli po ashtu vlerësoj, dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 171/2017 më datën 12.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.